

KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, më datë 31.05.2021, ditë e hënë, ne palët vendosëm në vullnetin tonë të lirë të përpilojmë këtë kontratë SHITJE mbi kuotën në pronësi të ortakut Silvana Kavaja e cila përkon me 49% të kapitalit themltar të shoqërisë **“Optical Point” Sh. P.K.**, regjistruar në Shqipëri, në QKB më datë 07.02.2017, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71407511U, me seli në Durrës, Lagjja nr. 11, Bulevardi Kryesor, Zona Kadastrale 8514, nr. Pasurie 1/167, si me poshtë vijon:

Subjektet:

Shitësi: 1. **Znj. Silvana Kavaja, atësia Mustafa**, lindur me 18.06.1976 ne Durres, shtetëse shqiptare, madhore, me zotesi te plotë juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti nr. 03-5124882, nr.personal H65618179F.

Blerësit: 1. **Z. Shkëlzen Llazani**, atësia Zamir, lindur me 21.11.1983 në Shkodër, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plotë juridike per te vepruar, identifikuar me pasaportë nr. BI6937844, nr.personal I31121029T;

Objekti dhe qëllimi i kontratës: Kalimi i pronësisë mbi kuotën e cila përkon me 49 % të kapitalit themltar, me vlerë 49.000 (dyzet e nëntëmijë) lekë në pronësi të ortakut Silvana Kavaja, ortake në shoqërinë **“Optical Point” Sh. P.K.**, në favor të blerësit z. Shkëlzen Llazani, **referuar Vendimit Të Asmblesë Së Ortakëve të Shoqërisë “Optical Point” Sh. P.K., nr. 1, datë 31.05.2021**, si më poshtë:

1. Kuota prej 49 % të vlerës së kapitalit themltar, me vlerë nominale 49.000 (dyzet e nëntëmijë) lekë, në pronësi të ortakut Silvana Kavaja, do t'i shitet e plotë në vlerën prej **49.000** (dyzet e nëntëmijë) lekë **z. Shkëlzen Llazani**.

Për shkak të shitjes së kuotës objekt i kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë do të përbëhet nga dy kuota të vetme dhe konkretisht:

- 1) **Z. Shkëlzen Llazani, behet** zotërues i një (1) kuote që përkon me 49 % të kapitalit themltar, me vlerë të përgjithshme: 49.000 (dyzet e nëntëmijë) lekë.
- 2) **z. Maksim Marku, mbetet** zotërues i një (1) kuote që përkon me 51 % të kapitalit themltar, me vlerë të përgjithshme: 51.000 (pesëdhjetë e njëmijë) lekë.

Baza ligjore:

Neni 761 e vijues i Kodit Civil te Republikës se Shqiperise; Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Aktet nenligjore ne zbatim.

Shitësi Silvana Kavaja, në cilësinë e ortakes të shoqërisë “Optical Point” Sh. P.K., me nënshkrimin e kësaj kontrate, konfirmon se në cilësinë e pronares/shitëses të kuotës objekt kontrate, shfaq vullnetin e saj të lirë dhe të plotë që pronësia mbi kuotën në pronësi të saj, siç u përcaktua më sipër në këtë kontratë, në kapitalin e shoqërisë **“Optical Point” Sh. P.K., të kalojë në favor të z. Shkëlzen Llazani**, dhe përrjedhojë edhe pronësia mbi shoqërinë dhe të gjitha të drejtat e shoqërisë, mbi të gjitha asetet e saj dhe pasuritë në pronësi të shoqërisë **“Optical Point”**



Sh. P.K t'i kalojnë (*t'ia shesë*) porpocionalisht me kuotën objekt i kesaj kontrate në mënyrë përfundimtare si më poshtë vijon:

1. Kuota që përkon në masën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **Optical Point Sh.P.K.**, në pronësi të znj. **Silvana Kavaja**, do t'i shitet në vlerën prej **49.000** (dyzet e nëntëmijë) lekë **z. Shkëlzen Llazani**.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate pala shitëse zhvishet në mënyrë përfundimtare nga të drejtat e pronësisë mbi kuotën në masën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **Optical Point Sh.P.K.**, objekt i kësaj kontrate.

Blerësi, z. Shkëlzen Llazani, ne cilesine e blerësit të kuotës objekt i kësaj kontrate, me nenshkrimin e kësaj kontrate shfaq vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **për të fituar pronësinë** mbi kuotën që përkon me 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **Optical Point Sh.P.K.**, siç është përcaktuar në këtë kontratë.

Me nenshkrimin e kësaj kontrate pala blerëse fiton në mënyrë përfundimtare të gjitha të drejtat dhe merr në përgjegjësinë e saj detyrimet mbi shoqërinë *porpocionalisht me kuotën objekt i kesaj kontrate dhe në këtë mënyrë, për shkak të kësaj kontrate kapitali themeltar i shoqërisë Optical Point Sh.P.K do të shpërndahet në pronësi të ortakëve të vetëm si më poshtë*:

Palet kane rene dakord që pronësia qe do te krijohet ne shoqerine si pasoje e kesaj kontrate do pasqyrohet si me poshte vijon:

Kapitali themeltar i shoqërise **Optical Point Sh.P.K** do të jetë 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital do të ndahet në dy (2) kuota.

Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë do të shpërndahet si më poshtë:

1. **z. Shkëlzen Llazani, behet** zotëruesh i një (1) kuote që përkon me 49 % të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme: **49.000** (dyzet e nëntëmijë) lekë.
2. **z. Maksim Marku, mbetet** zotëruesh i një (1) kuote që përkon me 51 % të kapitalit themeltar, me vlerë të përgjithshme: **51.000** (pesëdhjetë e njëmijë) lekë.

Palët, deklarojnë në vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë se kjo kontratë është hartuar dhe nenshkuar prej tyre duke qenë të vetëdijshëm me pasojet dhe efektet juridike që krijon ky veprim juridik.

Kjo marrëdhënie juridike do të rregullohet bazuar në legjislacionin shqiptar.


Kontrata u hartua ne 3 kopje originale dhe do të regjistrohet në registrat përkatës në zbatim të legjislacionit mbi të cilin zhvillohet kjo marrëdhënie juridike.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

1. Silvana Kavaja

Silvana Kavaja



BLERËSI

1. Shkëlzen Llazani

Shkëlzen Llazani

